



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE

MINISTRI

Nr. 809 Prot.

Tiranë, më 10 / 02 / 2021

URDHËR

Nr. 100, datë 10 .02 .2021

**PËR KUFIZIMIN E AKTIVITETEVE TË BAREVE, RESTORANTEVE, FAST FOOD
DHE LOKALEVE**

Në zbatim të nenit 7, pika 4 gërma b të ligjit Nr. 15/2016 “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive”, udhëzimit të Institutit të Shëndetit Publik si dhe në zbatim të Vendimit të Komitetit të Përkohshëm për Infeksionin e Përhapur nga Coronavirus i ri nr. 809 datë 10.02.2020, me qëllim parandalimin e përhapjes së infeksionit të shkaktuar COVID-19 në Republikën e Shqipërisë dhe mbrojtjen e shëndetit të popullatës,

URDHËROJ:

1. Kufizimin e aktivitetit të bareve, restoranteve, fast food dhe lokaleve që ofrojnë shërbim për klientët, nga ora 20:00 deri në orën 06:00, në të gjithë vendin, nga data 11.02.2021 deri në datën 25.02.2021.
2. Përfundim nga rregulli i përcaktuar në pikën 1, bëhet vetëm për shërbimin në banesë (delivery), i cili duhet të kryhet duke respektuar rregullat higjienike të miratuara.
3. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri organet kompetente për dhënien e masave administrative sipas Aktit Normativ Nr. 3, datë 15.03.2020 “Për marrjen e masave të veçanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së shkaktuar nga Covid-19” i ndryshuar.
4. Çdo urdhër i mëparshëm në kundërshtim me këtë urdhër, shfuqizohet.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

